

VENDIM Nr.151, datë 03.03.2010
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.828, DATË 30.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË
USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, NË FORMËN E SKRAPEVE", TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen "A" të listës që i bashkëlidhet vendimit nr.828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen numrat rendorë 2 dhe 4, me këtë përmbajtje:
"2. Nëndetëse 332 "Tufani";
4. Nëndetëse 334 "Vetëtima".".
2. Nëndetësja 332 "Tufani" dhe nëndetësja 334 "Vetëtima" të shiten, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha